

VENDIM
Nr. 117, datë 10.6.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HYDROBORSH” SHPK, PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) E
ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 2, germa “a”, 3, 4, germat “a” dhe “b”, 5, germa “j”, 6, 7, 9 dhe 10, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 770/12 prot., datë 7.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HYDROBORSH’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve fikse të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Fterra” dhe “Fterra 1”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 67, datë 6.6.2012.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770 prot., datë 12.3.2024, ajo ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve të paluajtshme të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a.

- Për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 56/2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëpërmjet shkresës nr. 929 prot., datë 15.4.2024.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 770/5 prot., datë 25.4.2024 dhe nr. 7701/0 prot., datë 30.5.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Me qëllim analizimin e sa depozituar nga shoqëria, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 31.5.2024, është vendosur zgjatja me 30 ditë pune e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve fikse të saj.

- Nga analiza përfundimtare e aplikimit, rezulton se shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga neni 7, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i” dhe “j”; pika 3, pika 4 dhe pika 6, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) e aseteve të paluajtshme të shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve fikse të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a. (sipas listës bashkëlidhur).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve të fikse të shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë

autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “HYDROBORSH” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

INVENTARI I ASETETEVE TË PALUAJTSHME HYDROBORSH 2024

Palët bien dakord se lista e asetëve të shoqërisë koncesionare “HYDROBORSH” sh.p.k., të cilat do të ofrohen kolateral në favor të “ABI Bank” sh.a., do të jetë ajo e përcaktuar si më poshtë:

- Ndërtesa HEC “FTERRE”, me vlerë 11,661,932 lekë;
 - Makineri & pajisje HEC “FTERRA”, me vlerë 25,726,931 lekë;
 - Linja 35 kw, me vlerë 28,720,658 lekë;
 - Aktiv ekonomik HEC “FTERRA” (përfshihen veprat e marrjes VM1 dhe VM2, tubacioni përcjellës plastik dhe çelik), me vlerë 76,680,859 lekë;
 - Ndërtesa HEC “FTERRA I BORSH”, me vlerë 24,016,597 lekë;
 - Makineri e pajisje HEC “FTERRA I BORSH”, me vlerë 32,549,869 lekë;
 - Aktiv ekonomik HEC “FTERRA I” (përfshihen VM3, kanali i derivacionit Fterre Borsh, tuneli, tubacion çeliku, sifonat dhe ai i presionit), me vlerë 213,076,376 lekë.
- Në total rezultojnë 412,433,222 lekë.